



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 69 datë 21-07-2025

**PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS TË MBLEDHJES
SË DATËS 21 KORRIK 2025 TË KËSHILLIT TË BASHKISË KORÇË**

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi shqyrtoi me këshilltarët dhe miratoi propozimet e paraqitura si dhe pikat e rendit të ditës të njoftuara për vendimarrje në njoftimin për mbledhjen e datës 14.07.2025, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 5 dhe neni 54, gërma k) si dhe neni 55 pika 3, pika 4 shkronja (a) e Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Korçë miratuar me VKB nr.80, datë 30.07.2020.

VENDOSI;

1. Të miratojë rendin e ditës për mbledhjen e Këshillit të Bashkisë Korçë sipas njoftimit bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miratuar me 22 vota

Vota Pro 22

Vota Kundër 3

Vota Abstenim 0

Zbardhur më datë 21-07-2025

KRYETARË

Ana VERUSHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK**

BASHKIA KORÇË
NR 6919 PROT
DATA 14/07/2025

Korçë më 14.7.2025

Lënda: Njoftim

Drejtuar: Këshilltarëve të Këshillit Bashkiak Korçë

Kryetarit të Bashkisë Korçë z.Sotiraq Filo

Njoftohen të gjithë këshilltarët e Këshillit Bashkiak Korçë dhe Kryetari i Bashkisë Korçë z.Sotiraq Filo, se ditën e **hënë**, datë **21 korrik 2025, ora 12⁰⁰** do të zhvillohet mbledhja jashtë radhe e Këshillit në sallën e Këshillit Bashkiak, me kërkesë të Kryetarit të Bashkisë nr.6919prot. datë 14.07.2025 dhe në zbatim të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", si dhe bazuar në Rregulloren e Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Korçë miratuar me VKB nr.80, datë 30.07.2020 me rend dite si më poshtë:

- 1- "PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS".
- 2- "PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES TË BASHKËPUNIMIT PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT TË INVËSTIMIT " PËR ZHVILLIMIN DHE MENAXHIMIN E PRONËS SHTETËRORE", NËNPROJEKTIT "RIJETËZIMI I KOMPLEKSIT SPORTIV SKËNDERBEU KORÇË DHE ZONËS URBANE RRETH TIJ " DHE VENDOSJEN NË DISPOZICION TË PROJEKTIT TË PRONAVE NË PRONËSI TË BASHKISË KORÇË".

(**Komisioni i Rregullores, Çështjeve ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë**)
z.Erjon Nexhipi, znj.Edlira Mire, z.Erjon kurti, z.Kristiano Kocibelli, znj. Ismeralda Seidolli.

Mbledhjet e komisioneve do të zhvillohen ditën e premte , datë 18.07.2025, ora 11⁰⁰ .

Komisionet do të zhvillojnë mbledhjet në sallën e Këshillit Bashkiak.

Kryetare e Këshillit Bashkiak

Ana VERUSHI

